



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr.47
Prishtinë, më 14.6.2019, në orën 11:50
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

P r o c e s v e r b a l

Nga takimi i përbashkët i Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike dhe i Komisionit për Integritet Evropian, me delegacionin nga Grupi i Miqësisë me shtetet e Evropës Juglindore të Bundestagut.

Në takim morën pjesë nga KPJDIS, deputetët: Elmi Reçica, Fitore Pacolli, Dukagjin Gorani, Evgjëni Thaçi-Dragusha, Zafir Berisha dhe nga KIE, nënkryetari Armend Zemaj, si dhe deputeti Ismajl Kurteshi.

Pjesëmarrës të delegacionit nga Grupi i Miqësisë me shtetet e Evropës Juglindore të Bundestagut: z. Josip Juratoviç, z. Hansjörg Müller, znj. Renata Alt dhe z. Jan Axel Voss.

Nga zyra e KPJDIS: Manush Krasniqi dhe nga zyra e KIE, Adelina Demolli e Ahtere Loxha.

Takimin e kryesoi: Armend Zemaj, nënkryetar i KIE.

Armend Zemaj, delegacionit nga Bundestagu Gjerman i dëshiroi mirëseardhje dhe prezantoi deputetët e të dy komisioneve, të pranishëm në takim. Ai njoftoi delegacionin mbi punën e KIE, duke bërë të ditur se puna e këtij komisioni zbatohet mbi bazën e MSA-së dhe ERA-s, mbikëqyrjen e harmonizimit të legjislacionit vendor me akuis komunitare, si dhe të obligimeve që dalin nga raporti për vendin. Po ashtu, z. Zemaj tha se janë të angazhuar për avancimin e gjendjes për perceptimin e shtetit, në mënyrë që t'i jepet drita e gjelbër Kosovës për liberalizimin e vizave. Njoftoi se shteti i Kosovës është falënderues për Bundestagun Gjerman, deputetët e euro deputetët e saj që e kanë mbështetur Kosovën në vazhdimësi.

Elmi Reçica, tha se në mungesë të kryetares dhe nënkryetarëve të KPJDIS, i dëshiron mirëseardhje delegacionit gjerman, duke theksuar se shtetin gjerman e konsiderojmë si shtetin më të afërt, më të fuqishëm dhe më mbështetës. Bëri të ditur se Kosova nuk ka rrugë e as alternativë tjetër pos integritet evropian, për perspektivën e saj dhe është e orientuar pro perëndimit e pro Brukselit dhe shumë e interesuar që të jetë e anëtarësuar në NATO. Më tej, z. Reçica theksoi se kemi një çështje që është e hapur dhe aktuale, atë të përmbushjes së dialogut me Serbinë. Njëkohësisht, tha se jemi shtet stabil dhe kemi marrëdhënie stabile me të gjitha vendet që na rrethojnë dhe i vetmi shtet që kemi çështje të hapur dhe jo stabilitet është Serbia. Në këtë drejtim, jemi të interesuar që si Kuvend dhe si individë, të kemi sa më shpejtë marrëveshje definitive me Serbinë dhe i kemi qëndrimet e qarta si Kuvend, se tërësia territoriale dhe organizimi i brendshëm

janë të panegociushme, se nuk ka shkëmbim të territoreve, e asnjë çështje që do ta destabilizonte rajonin dhe ndihen të sigurt se ajo marrëveshje do t'i ketë këto kondita.

Fitore Pacolli, tha se do të ndalet te disa çështje që po e prekin jetën e përditshme, jo vetëm tonën, por edhe të qytetarëve në të gjitha pjesët e Kosovës, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike apo besimin e tyre. Ajo tha se kemi filluar një dialog, i cili ka qenë pa parime dhe deri më sot është diskredituar komplet, është jo legjitim, nuk ka transparencë, mungojnë principet gjatë gjithë kohës së dialogut që është zhvilluar dhe është kthyer në një aventurë personale të disa personave, individëve që po e përdorin për interesa të tyre dhe mund ta çojnë çështjen e dialogut në një rrugë tepër të rrezikshme, e cila mund të shpie drejt destabilizimit të rajonit e të prekë edhe Bosnjën dhe vendet tjera në rajon. Po ashtu, njoftoi se është formuar edhe një ekip negociator shtetëror, që më së paku mund të quhet delegacion shtetëror, ngase është krijuar si mjet që ta përdorë Presidenti për të arritur iniciativën e tij. Gjykata Kushtetuese e ka konsideruar jokushtetues, që është një hap i mirë, sepse bie në kundërshtim me parimet e Kushtetutës dhe ka marrë 59 vota në Kuvend nga 120 vota. Shkëmbimi i territoreve ka ardhur si ide, pak më vonë e dialogu ka filluar pa parime konkrete, pa e ditur Kosova se ku do të përfundojë. Fatmirësisht, kjo ide nuk ka gjetur përkrahje as te qytetarët e Kosovës, përfshirë shqiptarët e serbët, përfshirë edhe Kuvendin, as te partitë politike opozitare. Kosova dhe Serbia duhet ta arrijnë një marrëveshje përfundimtare, por jo duke u ngutur dhe jo me këto figura që e kanë diskredituar procesin deri në këtë masë, kanë vendosur në rrezik të ardhmen e Kosovës e rajonit, tha ajo. Ne kemi nevojë për një dialog të ri me parime, që udhëhiqet nga njerëz të rinj, të përgatitur politikisht dhe që synojnë të arrijnë marrëveshje që do të ndikojë në përmirësimin e jetës së të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe që i hap rrugën Kosovës drejt integritetit në BE. Më tej, znj. Pacolli tha se dëshiron ta hapë një çështje që është me rëndësi, që është integrimi i serbëve të Kosovës në institucionet tona. Ndoshta, jeni të informuar se me Kushtetutën e Kosovës ata gëzojnë të gjitha të drejtat, mirëpo në praktikë ata janë lënë jashtë institucioneve, jashtë shkollave, jashtë universiteteve, pra nuk ka investime konkrete. Ne, si VV, mendojmë se ka një rrugë që të zgjidhet ky problem, që të bëhet integrimi i serbëve dhe etnive tjera në jetën shoqërore, kulturore, jo vetëm në institucionet zyrtare, siç është Kuvendi e Qeveria dhe për këtë duhet që Gjermania të na ndihmojë dhe Evropa në përgjithësi. Ne na duhet një lloj, sikurse i tipit të fondit të mareshalit, që do të ndihmonte në investime konkrete, sidomos në Mitrovicë, pa e ndarë qytetin në veri e jug, sepse nëse investojmë në Mitrovicë, atëherë serbët e shqiptarët do të punojnë bashkë, do të integrohen dhe do të lëvizin tutje. Deri më tani, investimet dhe projektet që janë paraparë për shoqërinë e Kosovës, popullin e saj drejt një shoqërie tolerante dhe për të arritur pajtimin në mes të etnive të caktuara, ka qenë gabim. P.sh. janë marrë disa të rinj shqiptarë e serbë, janë dërguar në Bruksel për një javë trajnim dhe janë kthyer në Kosovë. Kjo nuk i integron të rinjtë shqiptarë e serbë. Integrimi i vetëm është përmes punës së përbashkët, edukimit të përbashkët në shkolla e universitete të përbashkëta. Në Mitrovicë i kemi dy universitete, ku studentët serbë mësojnë në gjuhën serbe, ndërsa shqiptarët në gjuhën shqipe. Evropa e Gjermania do të duhej ta përdornin një teknikë pak më ndryshe, ku ndoshta do të silllej një universitet me renome botërore apo evropiane në Mitrovicë, ku do të kishim studentë jo vetëm prej veriut dhe jugut të Mitrovicës, por edhe nga vendet e tjera, dhe Mitrovica të krijohet si një qytet, ku do të vinin kultura e etni të ndryshme.

Zafir Berisha, tha se ambiciet legjitime të qytetarëve të Kosovës janë të lëvizin lirshëm në Kosovë. Kosova si tërësi nuk përbën ndonjë problem të madh për Evropën dhe do të tejkalohen edhe problemet politike, brenda BE-së, që qytetarëve të Kosovës t'u jepet mundësia, sepse një pjesë e kësaj shoqërie kanë kontribuar. Në dialogun me Serbinë, ajo që ka qenë kontestuese, tha se është kryer para 20 viteve, ku me ndihmën e NATO-s, Serbia e ka marrë përgjigjen. Ne, si NSD, jemi fuqishëm të interesuar që përmes dialogut, disa nga çështjet kontestuese që janë në mes dy vendeve fqinje, natyrisht të zgjidhen dhe rajoni të vazhdojë të jetë pjesë e Evropës. Ai tha se po e përsërit qëndrimin jomiqësor të Serbisë, karshi Kosovës, i cili keqpërdor serbët e Kosovës

për destabilizimin e Kosovës dhe gjermania dhe shtetet tjera evropiane duhet së paku ta kenë në konsideratë se politika aktuale në Serbi nuk dallon nga politika e Millosheviçit dhe kjo politikë luftënxitëse e Beogradit nuk shkon më në këtë shekull, siç kanë menduar në shekullin e kaluar. Në fund, z. Berisha tha se presim shumë nga shteti gjerman dhe janë mirënjohës edhe për angazhimin e jashtëzakonshëm që kanë bërë deri tani për rajonin dhe qytetarët e Kosovës.

Dukagjin Gorani, mes tjerash, tha se ne jemi të izoluar dhe duhet ta përmbyllim procesin e dialogut, mirëpo që të thuhet ky qark vicioz, udhëheqja kosovare dhe komuniteti i saj politik duhet ta marrin edhe guximin, edhe iniciativën që proceset jetike t'i përmbyllin. Ne, aktualisht, nuk e dëshirojmë as asociacionin me shumicë serbe dhe e refuzojmë idenë e korrigjimit të kufijve dhe nëse e pyetni këdo në komunitetin politik kosovar, se çka është me rëndësi për Kosovën, nuk do të ketë përgjigje, përveç refuzimit. Krijimi i mentalitetit të refuzuesit është duke na bërë dëm edhe në skenën e brendshme, por është duke e dëmtuar shumë edhe imazhin apo statusin, në kontestin rajonal e ndërkombëtar, për faktin që si shtet i ri po dështojmë që ta bartim një mesazh që ne nuk kemi pse të frikësohemi nga e ardhmja jonë, asgjë nuk mund të humbet përmes bisedimeve dhe përmes arritjes së marrëveshjeve. Këtë defanzivitet që jemi duke e krijuar, e ka krijuar një përkufizim të shtrembëruar të politikës, ku nuk bën pjesë kompromisi. Aktualisht, në shoqërinë tonë, politika dhe kompromisi janë dy gjëra të ndryshme. Të gjitha elementet, dialogu, qeverisja e keqe e izolimi, janë të ndërvarura dhe si të tilla ato vetëm sa e ushqejnë njëra-tjetrën. Si PSD, kemi provuar që ta thyejmë këtë qark të lidhur, ta hartojmë ligjin për dialogun dhe gjetjen e një formati, përmes të cilit komuniteti politik udhëheqës kosovar do të ishte në gjendje të prezantojë dhe të bashkëpunoj në procesin e paevitueshëm të bisedimeve Kosovë-Serbi. Opozita politike ka qenë kundër këtij koncepti dhe këtij formati dhe ligji për dialogun është dërguar në Gjykatën Kushtetuese dhe gjasat janë që ajo të sjellë vendim që një pjesë të kompetencave të delegacionit të bien ndesh me Kushtetutën, në ç' rast PSD detyrohet të tërhiqet nga delegacioni shtetëror, meqë duhet të respektohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Ky është një rivalitet politik, në të cilin aktualisht funksionojmë dhe personalisht shoh fare pak mundësi që mund të krijohet ndonjë qëndrim konsensual, që do ta përfshinte vetëdijen që dialogu është i domosdoshëm e i pashmangshëm. Nuk ka nevojë të kemi frikë. Ulja në tryezë të bisedimeve duhet të nënkuptojë gjetjen e gatishmërisë për gjetjen e rrugëzgjdhjes. Në fund, z. Gorani tha se këto ditë, kompromisi e politika janë shndërruar në dy gjëra dhe i vjen keq që do të shpenzohet edhe një vit pa zgjidhje të qartë.

Josip Juratoviç, gjatë diskutimit të tij, tha se populli i zgjedh deputetët, për t'i përfaqësuar ata, brenda dhe për t'ua zgjidhur problemet e tyre. Problemi i njerëzve në rajon dhe atyre që jetojnë këtu, është i njëjtë dhe sikur ta pyesnim një qytetar në Prishtinë, se cilat janë çështjet që politikanët presin t'i zgjidhin, do të ishin punësimi, shëndetësia e po të njëjtën përgjigje do ta kishim edhe nga qytetarët e vendeve të tjera të rajonit. Kompromisi është gjëja më e rëndësishme. Ai nuk duhet të trajtohet si tradhti, por si një hapi vogël më tutje dhe kjo është mrekullia e demokracisë. Më tej, shtoi se Procesi i Berlinit, pa CEFTEN funksionale, nuk është i mundur dhe ajo duhet të funksionojë, sepse pa zonë ekonomike nuk ka bashkëpunim. Parlamentarët janë përgjegjës kryesorë për gjithë atë që ndodh në këtë vend. Më tej, theksoi se është punuar në Kosovë, por ka edhe shumë për t'u bërë dhe duhet punuar që ne të mund t'ju ndihmojmë. Demokracia i ka vlerat e saj. Ju duhet të punoni, si përfaqësues të popullit, e jo si shefa të qeverive. Ky është roli parlamentar e po ashtu edhe roli i shoqërisë civile duhet të jetë konstruktiv. Z. Juratoviç tha se ne jemi në dispozicion për bashkëpunim, mund të vini në Berlin dhe mund të na ftoni këtu. Ne na duhet mbështetja dhe puna juaj, në mënyrë që t'i bindim evropianët, se Ballkani nuk është ashtu i keq, siç e shohim në media.

Renata Alt, në diskutimin e saj, pyeti deputetët: Pas zgjedhjeve evropiane, cilat janë planet e Kosovës, çka presin nga Komisioni Evropian, i ardhshëm? A ka bisedime me vendet e BE-së që

nuk e kanë njohur Kosovën? Çfarë është komunikimi me ata, në mënyrë që ta njohin Kosovën? Ajo tha se këto janë çështje të cilat u interesojnë gjatë 12 muajve të ardhshëm, për të cilat duhet të punohet, në mënyrë që pala gjermane të ndihmojë.

Armend Zemaj, tha se fjalët e z. Juratoviç janë porosi për ne, për obligimet që kemi ndaj qytetarëve tanë. Ai njoftoi palën gjermane, se janë duke punuar që të jenë më progresivë, ashtu siç e meriton shteti i Kosovës dhe qytetarët e saj. Bëri të ditur se ende nuk e kemi njohjen nga 5 vende të BE-së dhe mekanizmi më i mirë rajonal, për të na ofruar me këto vende, është diplomacia parlamentare. Ai, më tej, njoftoi për mënyrën e bashkëpunimit me deputetë evropianë dhe për gjendjen aktuale rreth raporteve me 5 vendet e BE-së, që nuk e kanë njohur Kosovën. Më tej, z. Zemaj tha se Kosova ka nevojë për mbështetje të Gjermanisë e po ashtu ka nevojë për angazhim shtesë dhe që t'i bashkërendojë shumë tema, t'i përmirësojnë dhe që ata që bien ndesh me ligjin apo që gabojnë, të largohen nga skema politike. Ai, po ashtu, bëri të ditur se Kosova ka një rini të shkëlqyeshme, e cila mund ta udhëheqë vendin, me duar të pastra dhe të përgatitur profesionalisht.

Ismajl Kurteshi, falënderoi palën gjermane për angazhimin e madh në drejtim të zgjidhjes së drejtë të problemit në mes të Kosovës e Serbisë. Ai tha se është e natyrshme që Gjermania dhe Evropa demokratike, të angazhohet për një marrëveshje përfundimtare, por ajo është e mundur vetëm kur arrihet një marrëveshje e drejtë, sepse nga historia e dimë se marrëveshjet e imponuara nuk mund të jenë përfundimtare dhe këtë e kemi përjetuar në vitin 1878 në Kongresin e Berlinit dhe në vitin 1945, me vendimin e AVNOJ-it. Më tej, tha se si qytetarë të Kosovës jemi të gatshëm për barazi në mes të qytetarëve të Kosovës, pavarësisht përkatësisë fetare e kombëtare dhe kërkojmë që të respektohet reciprociteti gjatë marrëveshjeve në mes të vendeve. Po ashtu, theksoi se kompromisi është i rëndësishëm, por edhe ai duhet të ketë kufij dhe për 8 vite dialog, është biseduar për rregullimin e brendshëm të Kosovës, gjë që i tejkalon të gjitha vijat e kompromisit. Më tej, z. Kurteshi tha se Serbia e ka synim ndarjen e Kosovës. Atë mundohet ta bëjë, qoftë përmes korrigjimit të kufijve, qoftë përmes asociacionit të komunave serbe, të cilin asociacion po e kërkojnë ata, është përtej asociacionit. Serbia po ec me hapa të mëdhenj drejt integritetit në BE, por askush nuk po e vëren se shqiptarët që jetojnë në Luginën e Preshevës janë komuniteti më i diskriminuar në Evropë. Nga Komisioni Evropian presim një trajtim të barabartë të të dyja palëve. Në fund, ai shtoi se znj. Mogerini e ka shtyrë përpara projektin e Serbisë për ndarjen e Kosovës, që e kemi konsideruar të padrejtë dhe znj. Mogerini e kemi konsideruar argat të Serbisë dhe jo ndërmjetësuese të drejtë.

Armend Zemaj, falënderoi për takimin Ambasadën e Gjermanisë dhe deputetët gjermanë, të cilëve u dhuroi një dhuratë simbolike.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

Anëtar i komisionit,

Elmi Reçica

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit për Punë të Jashtme,
Diasporë dhe Investime Strategjike.